LIGJ
Nr.10 295, datë 1.7.2010

PËR FALJEN

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 92 shkronja "b" të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton kriteret dhe procedurat e dhënies së faljes për personin që vuan dënim për vepra penale të kryera dhe në vijim quhet "person i dënuar".

Neni 2
Kuptimi i faljes

1. Falja është një akt human i jashtëzakonshëm mëshire, me natyrë individuale, që synon të rivlerësojë personalitetin e personit të dënuar. Falja e dënimit jepet kur çmohet se dënimi i vuajtur ka arritur qëllimin edukues dhe riintegrues të të dënuarit dhe vuajtja e mëtejshme e dënimit bie ndesh me thelbin e drejtësisë. Akti i faljes nuk prek fuqinë juridike ose ligjshmërinë e një vendimi gjyqësor.

2. Falja nuk shuan dënimet plotësuese, përveç kur dekreti i Presidentit të Republikës parashikon ndryshe. Në çdo rast falja nuk shuan efektet e tjera penale apo civile të dënimit.

3. Falja tërësisht e dënimit nënkupton përjashtimin nga vuajtja e dënimit kryesor në tërësinë e tij dhe, nëse ka, edhe atij plotësues.

4. Falja pjesërisht e dënimit nënkupton përjashtimin nga vuajtja e një pjese të caktuar të tij, të llogaritur në raport me dënimin në tërësi dhe pjesën e dënimit që ka mbetur për t'u ekzekutuar, ose përjashtimin nga vuajtja e një prej llojeve të dënimeve të dhëna. Në rastin e faljes së pjesshme të dënimit, në dekretin e Presidentit të Republikës caktohet shprehimisht masa dhe lloji i dënimit të falur.

5. Zëvendësimi i dënimit nënkupton ndryshimin e llojit të dënimit kryesor me një lloj dënimi më të butë.

Neni 3
Falja e dënimeve të dhëna për kryerjen e disa veprave penale

Në rastin e personit të dënuar për kryerjen e disa veprave penale, falja e dënimit caktohet mbi vendimin gjyqësor që ka bashkuar dënimet. Në dekretin e Presidentit të Republikës përmenden dënimet kryesore dhe, sipas rastit, ato plotësuese, për veprat penale të veçanta, për të cilat jepet falja e dënimit.

Neni 4
Periudha për ushtrimin e faljes

Presidenti i Republikës nuk mund të dekretojë faljen e një të dënuari tre muaj para dhe tre muaj pas datës së zgjedhjeve të përgjithshme, të dekretuara prej tij.

KREU II
KRITERET PËR FALJEN E DËNIMIT

Neni 5
Kritere për faljen e dënimit

Falja e dënimit mund të jepet kur:

a) nuk ekzistojnë kriteret ndaluese të parashikuara në ligj;

b) personi i dënuar ka vuajtur më shumë se një të tretën e dënimit të dhënë;

c) personi i dënuar me sjelljen, punën dhe veprimet e tij tregon se nëpërmjet dënimit të vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe rehabilitimin shoqëror të tij;

ç) përmbushet të paktën njëri prej kritereve të mëposhtme:

i) personi i dënuar në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i mitur;

ii) kur për shkak të sëmundjes dhe moshës së personit të dënuar nuk justifikohet më vazhdimi i mëtejshëm i vuajtjes së dënimit; ose

iii) kur e dënuara është me fëmijë të mitur.

Neni 6
Kritere ndaluese për faljen e dënimit

1.Falja e dënimit nuk jepet në rastet kur:

a) vendimi gjyqësor nuk ka marrë formë të prerë apo nuk është bërë i ekzekutueshëm;

b) ka përfunduar ekzekutimi i vendimit;

c) ekzekutimi i vendimit nuk ka filluar, për shkak se i dënuari i është shmangur ekzekutimit;

ç) personi i dënuar ka kryer veprën penale me egërsi dhe mizori, apo kundër fëmijëve, grave shtatzëna a personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen;

d) personi është dënuar për veprat penale të parashikuara në dispozitat e mëposhtme të Kodit Penal: neni 73 “Gjenocidi”; neni 74 “Krime kundër njerëzimit”; neni 75 “Krimet e luftës”; neni 78 paragrafi 2 “Vrasja me paramendim”; neni 100 “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”; neni 114/a “Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese”; neni 114/b “Trafikimi i femrave”; neni 128/b “Trafikimi i të miturve”; neni 230 “Vepra me qëllime terroriste”; neni 234/a “Organizata terroriste”; neni 333 “Organizata kriminale”;

dh) personi është dënuar me burgim të përjetshëm;

e) personi ka kryer një vepër penale, pasi ka përfituar nga falja tërësore, falja e pjesshme ose zëvendësimi i dënimit;

ë) ndalohet shprehimisht me ligj.

2. Falja e dënimit nuk jepet edhe në rastin kur personi është dënuar për disa vepra penale dhe njëra prej tyre përfshihet në kriteret ndaluese të këtij neni.

Neni 7
Vlerësimi i rrethanave për faljen e pjesshme ose zëvendësimin e dënimit

Presidenti i Republikës, në ushtrimin e së drejtës së faljes së pjesshme ose të zëvendësimit të dënimit, përveç kritereve të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, vlerëson edhe

këto rrethana:

a) rrezikshmërinë e veprës penale të kryer;

b) pendimin e thellë;

c) sjelljen e personit të dënuar; si dhe

ç) çdo rrethanë tjetër të veçantë të personit të dënuar, që justifikon faljen e pjesshme ose zëvendësimin e dënimit.

Neni 8

Rrethi i personave kërkues për faljen e dënimit

Kërkesa për faljen e dënimit bëhet personalisht nga personi i dënuar ose personi i pajisur me autorizim prej tij, sipas rregullave të legjislacionit në fuqi. Në rastin e personave të dënuar të mitur kërkesa për falje bëhet nga njëri prej prindërve, nga personi i autorizuar me prokurë prej tyre ose nga kujdestari.

KREU III

PROCEDURA E FALJES SË DËNIMIT

Neni 9

Paraqitja dhe shqyrtimi i kërkesës për faljen e dënimit

1. Kërkesa drejtuar Presidentit të Republikës për falje depozitohet në Ministrinë e Drejtësisë dhe duhet të përmbajë:

a) kopje të vendimit penal të dënimit, për të cilin kërkohet falja;

b) shkaqet ligjore të kërkimit të faljes së dënimit;

c) kopje të letërnjoftimit të personit të dënuar;

ç) dokumentacionin për gjendjen familjare të tij;

d) çdo dokument tjetër që tregon përmbushjen e kritereve ose rrethanave të përcaktuara në këtë ligj për dhënien e faljes.

2. Ministri i Drejtësisë, brenda shtatë ditëve nga marrja e kërkesës së të dënuarit, i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve informacion për:

a) veprën penale, për të cilën është dënuar, llojin dhe masën e dënimeve të dhëna;

b) periudhën e vuajtur të dënimit me burgim apo të çdo dënimi tjetër kryesor ose plotësues;

c) vlerësimin periodik për sjelljen dhe personalitetin e personit të dënuar nga institucioni ku vuan dënimin dhe organet e shërbimit të provës për të, nëse ka.

3. Pasi merr informacionin nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë nga marrja e kërkesës për falje, Ministri i Drejtësisë, në varësi të rrethanave të çështjes, mund t’i kërkojë:

a) gjyqtarit që ka dhënë vendimin e dënimit, të paraqesë mendimin e tij për kërkesën e të dënuarit për falje. Ky mendim mbetet konfidencial dhe nuk i jepet personave të tretë;

b) prokurorit që ka hetuar çështjen, të paraqesë me shkrim mendimin e tij për kërkesën e të dënuarit për falje. Ky mendim mbetet konfidencial dhe nuk i jepet personave të tretë;

c) institucioneve shtetërore ose subjekteve të tjera të interesuara, të paraqesin mendimin mbi kërkesën për falje dhe dokumente të tjera, që mund të jenë të nevojshme për propozimin e faljes së dënimit.

4. Institucionet dhe subjektet e përmendura në pikën 3 të këtij neni i paraqesin Ministrit të Drejtësisë informacionin e kërkuar brenda tridhjetë ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

Neni 10

Dërgimi i akteve te Presidenti i Republikës

1. Ministri i Drejtësisë, jo më vonë se gjashtëdhjetë ditë nga data e depozitimit të kërkesës, i paraqet Presidentit të Republikës praktikën përkatëse, të përgatitur sipas kërkesave të këtij ligji, veçanërisht të kërkesave të kreut II të tij, së bashku me propozimin e tij për pranimin e kërkesës apo refuzimin e kërkesës për falje. Propozimi i Ministrit të Drejtësisë shoqërohet me arsyetimin e plotë ligjor për çdo kërkesë.

2. Presidenti i Republikës, nëse çmon se praktika e përcjellë për faljen e dënimit nuk është e plotë nga aktet, brenda tridhjetë ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, njofton Ministrin e Drejtësisë për rishqyrtimin dhe plotësimin e të metave.

3. Ministri i Drejtësisë, brenda tridhjetë ditëve nga data e marrjes së njoftimit, sipas pikës 2 të këtij neni, merr masa për plotësimin e kërkesës për falje dënimi dhe ia ridërgon Presidentit të Republikës për shqyrtim.

Neni 11
Përmbajtja e dekretit të Presidentit të Republikës për faljen e dënimit

1. Falja e dënimit ushtrohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.

2. Dekreti i Presidentit të Republikës për faljen e dënimit përmban:

a) gjenealitetet e personit të dënuar;

b) të dhëna mbi vendimin gjyqësor të dënimit, duke treguar gjykatën që e ka dhënë, numrin dhe datën e tij, veprën penale, për të cilën është dënuar, llojin dhe masën e dënimit që kërkohet të falet dhe masën e vuajtur të dënimit deri në datën e dhënies së faljes;

c) referencën në këtë ligj dhe arsyetimin ligjor përkatës;

ç) mënyrën e faljes së dënimit, sipas rastit, tërësisht apo pjesërisht, duke përcaktuar shprehimisht pjesën e dënimit të falur apo llojin dhe masën e dënimit më të butë, që zëvendëson dënimin e dhënë me vendimin gjyqësor.

Neni 12
Shpallja e dekretit për faljen e dënimit

1. Dekreti i Presidentit të Republikës për faljen e dënimit hyn në fuqi në datën e caktuar shprehimisht në të dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

2. Kopje e dekretit të Presidentit të Republikës për faljen e dënimit i dërgohet për ekzekutim, sipas rregullave të legjislacionit në fuqi, Ministrit të Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Neni 13
Rrëzimi i kërkesës për falje dënimi

1. Nëse Presidenti i Republikës nuk shprehet brenda afatit prej tridhjetë ditësh, sipas nenit 10 të këtij ligji, kërkesa për falje dënimi konsiderohet e rrëzuar. Në këtë rast Ministri i Drejtësisë njofton kërkuesin për kalimin e afatit, sipas këtij neni.

2. Kërkesa nuk mund të përsëritet nga i dënuari përpara se të kenë kaluar gjashtë muaj nga data e kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 14
Arkivimi i akteve

1. Në arkivin e Ministrisë së Drejtësisë mbahet kopje e plotë e dosjes së faljes për çdo

kërkues, e cila përmban, sipas rastit, edhe:

a) dekretin e Presidentit të Republikës për faljen e dënimit;

b) njoftimin e Ministrit të Drejtësisë, sipas pikës 1 të nenit 13 të këtij ligji.

2. Ministria e Drejtësisë mban një regjistër publik, në të cilin evidentohen të gjitha kërkesat e paraqitura për falje, duke shënuar datën e depozitimit të kërkesës në Ministrinë e Drejtësisë, gjenealitetet e të dënuarit, llojin dhe masën e dënimit të dhënë nga gjykata, masën e dënimit të vuajtur, si dhe datën e dërgimit të praktikës te Presidenti i Republikës.

KREU IV
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 15
Dispozitë kalimtare

1. Rregullat e këtij ligji zbatohen edhe për kërkesat e paraqitura para hyrjes në fuqi të tij, për të cilat Presidenti i Republikës nuk është shprehur me dekret.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Ministria e Drejtësisë krijon regjistrin publik, sipas pikës 2 të nenit 14 të këtij ligji.

Neni 16
Shfuqizim

Ligji nr. 6299, datë 27.3.1981 “Për faljen”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)